



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.5

2004

19 shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9169 datë 22.1.2004	Për ratifikimin e Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të 21 marsit 1983 “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë...	135
Vendim i Kuvendit nr.117, datë 26.1.2004	Për ndryshime në përbërjen e Komisionit të Integritetit.....	137
Vendim i Kuvendit nr.119, datë 29.1.2004	Për zgjedhjen e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.....	138
Vendim i KM nr.67, datë 22.1.2004	Për miratimin e uniformës dhe të shenjave dalluese të Gardës së Republikës të Shqipërisë.....	138
Vendim i GJK nr.3, datë 11.2.2004	Me objekt shfuqizimin e neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë...	142
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Leonidha Hida	146
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllumb Mema	146

L I G J
Nr. 9169, datë 22.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË KONVENTËS EUROPIANE TË 21 MARSIT 1983 "PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR" NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja shtesë e Konventës Europiane të 21 marsit 1983 "Për transferimin e personave të dënuar" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4123, datë 9.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
SHITESË E KONVENTËS MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR
TË 21 MARSIT 1983

Republika e Shqipërisë dhe Republika Italiane:

duke dashur të intensifikojnë dhe të lehtësojnë bashkëpunimin në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në zbatimin e Konventës Europiane mbi transferimin e personave të dënuar të 21 marsit 1983 (e përmendur më poshtë si "Konventa");

duke konsideruar të përshtatshëm plotësimin e Konventës në disa pika, me qëllim shtrirjen e zbatimit edhe me forma të tjera të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje duhen interpretuar sipas Konventës.

2. Dispozitat e Konventës janë të zbatueshme në masën që janë të pajtueshme me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Kur në njërin prej shteteve është shpallur një vendim dënimi i formës së prerë ndaj një shtetasi të shtetit tjetër, ky i fundit, me kërkesën e shtetit dënues, mund të procedojë me ekzekutimin përkatës, në rast se personi i dënuar ndodhet në territorin e tij, në përputhje me normativat e brendshme lidhur me njohjen e vendimit gjyqësor.

2. Me kërkesën e shtetit dënues, shteti ekzekutues, përpara marrjes së dokumentacionit mbështetës të kërkesës ose në pritje të vendimit përkatës për këtë kërkesë, mund të procedojë me arrestimin e personit të dënuar ose me marrjen e çdo lloj mase për të garantuar që ai të mbetet në territorin e tij në pritje të një vendimi lidhur me kërkesën. Në këtë kuptim kërkesat shoqërohen me informacionet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 4 të Konventës. Ky arrestim i personit të dënuar nuk mund të çojë në një rëndim të situatës penale të tij.

3. Për ekzekutimin e vendimit të dënimit sipas këtij neni, nuk është e nevojshme marrja e pëlqimit të personit të dënuar.

Neni 3

Me kërkesën e shtetit dënues, shteti ekzekutues, duke përfshirë zbatimin e dispozitave të këtij neni, mund të lejojë transferimin e një personi të dënuar pa pëlqimin e këtij të fundit kur vendimi i shpallur ndaj tij ose një masë administrative e formës së prerë, sipas rregullit të brendshëm të shtetit dënues, shpie në një masë dëbimi ose shoqërimi deri në kufi, në zbatim të së cilës personi i dënuar, pas daljes së tij nga burgu, nuk mund të qëndrojë më në territorin e shtetit dënues.

Shteti ekzekutues e jep pëlqimin e tij në bazë të paragrafit 1 vetëm pasi të ketë dëgjuar mendimin e personit të dënuar.

Me qëllim zbatimin e këtij neni, shteti dënues i përcjell shtetit ekzekutues:

a) Një deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e mundshëm të tij.

b) Një kopje të vendimit të dënimit ose të masës administrative të formës së prerë, që sjell si pasojë një masë, sipas së cilës personi i dënuar, pas daljes së tij nga burgu, nuk mund të qëndrojë më në territorin e shtetit dënues.

Çdo person i transferuar, në zbatim të këtij neni, nuk do të ndiqet, gjykohet, t'i hiqet liria, me qëllim ekzekutimin e një vendimi ose mase sigurie, ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër lirie personale për çfarëdolloj veprë të kryer më parë, që nuk ka të bëjë me transferimin, të ndryshme nga ai që ka motivuar dënimin e zbatueshëm, me përjashtim të rasteve:

a) Kur shteti i dënimit e autorizon: për këtë qëllim paraqitet një kërkesë e pajisur me dokumentacionin përkatës dhe me procesverbalin gjyqësor, që përmban deklaratat e personit të dënuar; ky autorizim jepet kur vepra penale për të cilën kërkohet parashikon ekstradimin, në përputhje me legjislacionin e shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtojë vetëm nga arsyeja e shkallës së dënimit.

b) Kur, duke pasur mundësinë për ta bërë, personi i dënuar nuk e lë, edhe në dyzet e pesë ditët e adhshme nga lirimi i tij përfundimtar nga burgu, territorin e shtetit ekzekutues ose nëse kthehet pasi e ka lënë atë.

Pavarësisht nga rregullat e paragrafit 4 të këtij neni, shteti ekzekutues mund të marrë masat e domosdoshme, në përputhje me legjislacionin e tij, duke përfshirë këtu rekursin në një proces në mungesë, me qëllim ndërprerjen e parashikimit.

Neni 4

Për ekzekutimin e vendimeve, zbatohet neni 9 paragrafi 1 shkronja (a) e Konventës.

Neni 5

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna si përpara, ashtu dhe pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 6

Kërkesa e transferimit dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet të përcillen në gjuhën e shtetit ekzekutues, të cilit i janë drejtuar.

Neni 7

Shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë në ngarkim të shtetit dënues, me përjashtim të shpenzimeve të bëra vetëm në territorin e shtetit ekzekutues.

Neni 8

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet procedurës së ratifikimit dhe hyn në fuqi datën e marrjes së njoftimit të dytë, përmes të cilit shteteve do t'u komunikohet zyrtarisht që procedurat e brendshme përkatëse të ratifikimit janë përbushur.

Me besim për sa më sipër, palët nënshkruese kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Romë, më 24.4.2002 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe atë italiane, të konsideruara të dy teksteve njësoj të barasvlershme.

VENDIM

Nr. 117, datë 26.1.2004

PËR NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË STABILITETIT

Në mbështetje të nenit 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Ylli Bufi caktohet anëtar i Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit, në vend të deputetit Marko Bello.

II. Deputetja Valentina Leskaj caktohet anëtare e Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

VENDIM
Nr. 119, datë 29.1.2004

**PËR ZGJEDHJEN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 4 dhe 65 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhet Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Pjetër Dema | Kryetar |
| 2. Rajmonda Ismailaj | anëtar |
| 3. Petrit Ahmeti | anëtar |
| 4. Adriatik Bego | anëtar |
| 5. Entela Çipa | anëtar |
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 67, datë 22.1.2004

**PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË SHENJAVE DALLUESE TË GARDËS SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e uniformës së Gardës të Republikës, sipas albumit dhe specifikimeve teknike, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Uniformat e punonjësve të nivelit madhor, të lartë, të mesëm e të ulët të Gardës së Republikës janë:

- a) uniforma ceremoniale;
- b) uniforma e punës;
- c) uniforma e stërvitjes dhe e kohës së luftës;
- ç) uniforma civile.

2. Miratimin e shenjave dalluese të Gardës së Republikës, sipas albumit dhe specifikimeve teknike, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohet Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR UNIFORMËN E GARDËS SË REPUBLIKËS

1. UNIFORMA CEREMONIALE

Do të ketë kostum, i cili do të përfshijë 1 kapele, 1 xhakete, 1 palë pantallona, fjongo (përbërja e saj do të jetë fill pambuku i verdhë), doreza, këpucë gjysma të zeza, rrip pantallonash.

Xhaketa do të jetë prej stofi 100 për qind lesh me ngjyrë të kuqe dhe me jakë të mbyllur, ka dy xhepa me kapak, mbyllet me 7 çifte kopsash të verdha me shqiponjë. Xhaketa në pjesën e jakës dhe kapakët e xhepave dhe të përparësës së majtë përshkohet nga shirita prej stofi të zi 1.2 dhe 1.3 cm. Gjethja në jakë është qëndisur me fije ngjyrë ari. Po kështu në pjesën e përparme të mëngëve është qëndisur me fill të zi shqiponja dhe përkrenarja e Skënderbeut me fill ngjyrë ari. Xhaketa te supet ka dy spaleta pllakë me ngjyrë të verdhë me shirit të kuq 0.5 cm në mes.

Pantallonat do të kenë dy xhepa të pjerrët dhe dy pensa përpara. Pantallonat përbëhen prej stofi të zi me përzierje 45% lesh dhe 55% poliestër $\pm 5\%$, masa 240 ± 8 gr/m². Pantallonat kanë në anësore dy shirita të kuq 1.8 deri 2 cm të larguar nga njëri-tjetri 8 deri në 10 mm.

Kapelja përbëhet prej stofi të zi dhe stofi të kuq me material si pantallonat, përzierje 45% lesh dhe 55% poliestër $\pm 5\%$, masa 240 ± 8 gr/m². Në rrethin e saj përshkohet nga një shirit i kuq 3 deri 4 mm. Kapelja ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.

Fjongo (fill pambuku) i thurur me ngjyrë të verdhë me tufëza. Fjongoja do të vendoset në pjesën e përparme të xhaketes, në krahun e djathtë.

Ky kostum do të përdoret në raste ceremonish, festash e dekorimesh të ndryshme.

2. UNIFORMA E PUNËS

Do të ketë kostum që përfshin 1 kapelë, 1 xhakete, 2 palë pantallona, këmishë me mëngë të gjata për periudhën dimër vjeshtë, këmishë me mëngë të shkurtra për periudhën pranverë verë, kravatë me ngjyrë të zezë, këpucë gjysma uniforme, rrip pantallonash.

Kostumi (xhaketa dhe pantallonat, kapelja) do të jetë material stofi me ngjyrë të zezë me përzierje 45% lesh 55% poliestër $\pm 5\%$, masa 240 ± 8 gr/m².

Xhaketa do të jetë e hapur monopet me katër kopsa të verdha me shqiponjë. Në spalina dhe 10 cm nga buza e mëngës përshkohet nga një shirit i kuq 3 deri 4 mm.

Pantallonat e drejta me dy pensa përpara, dy xhepa të pjerrët dhe një xhep prapa me kapak, në anësore përshkohet nga një shirit i kuq 3 deri 4 mm.

Kapelja e zezë me shirit të kuq në rrethin e saj me përmasa 3 deri 4mm. Kapelja do të jetë me strehë plastike të zezë.

Kapelë alpine: për femra materiali si i kostumit. Kapelja do të jetë me shirit të bardhë ose të verdhë me përmasa 1-1.5 cm.

Këmisha me mëngë të gjata ka ngjyrë të bardhë me jakë të kollarisur, është puclin me përzierje 65% poliestër dhe 35% pambuk $\pm 3\%$, masa 104 gr/m².

Këmisha me mëngë të shkurtra ka ngjyrë kaki të hapur, me jakë tip sport ose të kollarisur, me dy xhepa në pjesën e gjoksit, me spaleta; është puclin me përzierje 65% poliestër dhe 35% pambuk $\pm 3\%$, masa 104 gr/m².

Kravatë prej teritali me ngjyrë të zezë.

Këpucë ½ uniforme: ngjyra e zezë, lëkura boks viçi, astar meshini, taban soleti, gomë e presuar ose shollë, me lidhëse.

Rrip pantallonash: do të përbëhet nga najlon i thurur, ngjyra e zezë, togëz ngjyrë argjendi dhe bronxi.

Kjo uniformë do të përdoret në ambientet e punës (përfshijë stërvitjen).

3. UNIFORMA PËR SHËRBIM, STËRVITJE E KOHË LUFTE

Do të përbëhet nga kostum, 1 kapelë, 1 xhakete, 1 palë pantallona, bluzë pambuku me mëngë të shkurtra, këpucë me qafa stërvitjeje, rrip mesi brezent, rrip pantallonash, shall mëndafshi i kuq. Ky kostum do të jetë prej materiali dok trikoton me përzierje 65% poliestër e 35% $\pm 3\%$, masa 218 ± 8 gr/m². Kostumi do të ketë ngjyrë të zezë.

Xhaketa do të jetë e mbyllur me nga dy xhepa pllakë në pjesën e sipërme dhe të poshtme.

Një xhep në krahun e majtë me kapak. Pjesët e përparme të xhaketes mbërthehen me 5 deri 6 kopsa, në supe ka dy spalina. Jaka, spalinat përshkohet nga një shirit të kuq 3 deri 4 mm.

Mëngët në pjesën e përparme dhe pjesa e shpinës (të shpatullave) përshkohet nga një shirit i kuq 7 deri 8 mm. Mëngët në bëryla bëhen me fortesë nga i njëjti material.

Pantallonat janë me dy pensa përpara, xhepat e pjerrët dhe një xhep prapa me kapak. Ka dy xhepa pllakë me kapak në anësore. Anësoret përshkohen nga një shirit i kuq 7 deri 8 mm.

Fund për femra: është i drejtë deri në gju, pak i gjerë me qemer prej stofi me një të prerë nga mbrapa.

Kapelja do të jetë tip sport me strehë të veshur, pjesa rreth e rrotull është dypjesëshe dhe përshkohet nga dy shirita të kuq 3 deri 4 mm të baraslarguara nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Në ballore ka fortesë për vendosjen e emblemës. Nga brenda vishet me astar mëndafshi të zi.

Bluza me mëngë të shkurtra do të jetë 100% pambuk, me ngjyrë të zezë dhe me jakë rrethore.

Rripi i mesit do të jetë prej najloni të thurur me ngjyrë të zezë me 10 çifte syzesh metalike, me togëz ebaniti ose metalike.

Këpucë me qafa stërvitjeje: ngjyra e zezë, lëkura boks viçi, astar meshini, taban soleti, gomë e presuar me shollë, me lidhëse.

Rrip pantallonash: najlon i thurur, ngjyra e zezë, togëz ngjyrë argjendi dhe bronxi.

Kjo uniformë do të përdoret në programet stërvitore dhe shërbimet e ndryshme që kryhen njësisia.

4. MATERIALE SHITESË QË DO TË PËRDOREN SIPAS NATYRËS SË SHËRBIMIT DHE STINËS

Xhup sintetik 3/4 me kapuç. Lënda e parë 100% poliamid, me llustër nga brenda me ngjyrë të zezë. Masa 140 ±8 gr/m². Xhupi ka dy xhepa të pjerrët në pjesën e poshtme dhe një xhep në pjesën e brendshme.

Xhupi nga brenda vishet me astar mëndafshi me ngjyrë të zezë, me vatin 150 deri 180 gr/m² e ndërthurur në formë rombi. Xhupi përdoret me uniformën e shërbimit dhe të stërvitjes në periudhën dimërore.

Xhakavento: Stof teritali ngjyra e zezë, astar mëndafshi ngjyra e zezë, jaka akrilik gjysmë rrethore, ka dy xhepa të pjerrët në pjesën e poshtme. Përdoret në periudhën pranverë vjeshtë.

Pelerinë ose mushama shiu. Materiali 100% poliamid i padepërtueshëm nga uji (pëlhurë e gomuar, e plazmuar, sintetike). Ngjyra e zezë. Pelerina të jetë me mëngë të gjata, kapuçi mund të bëhet i çmontueshëm.

Pallto ose pardesy. Lënda e parë 100% lesh, ngjyra e zezë jaka e hapur. Pjesët e përparme mbërthehen me tri kopsa, ka rrip të zi prej të njëjtit material. Palltoja përdoret me uniformën e punës në periudhën dimërore.

Pulovër leshi, ngjyra e zezë, thurja llastik, jaka në formë v-je ose e mbyllur me zinxhir me dy spalina të kuqe.

Shall mëndafshi ose kashmiri me ngjyrë të kuqe.

Çorapë najloni ose pambuku, ngjyrë të zezë.

Pantallona vere ngjyrë të zezë, material terital si ai e kostumit. Pantallonat përbëhen nga xhepat e pjerrët dhe një xhep prapa me kapak.

Doreza. Shevro keci me ngjyrë të zezë me astar dhe push nga brenda.

Sa më sipër, rezulton të jenë këto ndryshime mes dy uniformave, asaj ekzistuese dhe uniformës së re:

- hiqen çizmet e gjata lëkure,
- hiqen këpucët me qafa kuadri,
- shtohet pulovra,
- shtohen dorezat,
- shtohet rrip pantallonash,
- shtohen çorapet,
- shtohet bluzë pambuku me mëngë të shkurtra,
- shtohet kostum civil,
- zëvendësohet kapota e leshit ose pardesyja kaki me xhup sintetik 3/4 me kapuç ose pallto,

- zëvendësohet kostumi i leshit ose ai terital për kohën e lirë me kostum ceremonial,
- zëvendësohet kostumi i leshit ose ai terital për kohën e punës me kostum pune,
- zëvendësohet kostum leshi trupe shevjot me kostum stërvitjeje dimri,
- zëvendësohet kostumi i dokut kaki për stërvitje e kohë lufte me kostum stërvitjeje vere,
- zëvendësohen bluzat e verës kaki me këmishë me mëngë të shkurtra,
- zëvendësohet këmisha bezhë për uniformën e kohës së lirë me këmishën me mëngë të gjata,
- zëvendësohet rripi i mesit krahëqafë lëkure me rrip mesi brezent (fije najloni).

Çizmet e gjata të lëkurës që përdoren me pantallona qillot tashmë kanë dalë jashtë funksionit. Edhe këpucët me qafa kuadri për vetë natyrën e shërbimit dhe venddislokimit të njësisë janë të panevojshme, pasi do të përdorin këpucë gjysma uniforme.

Dhënia e pulovrit dhe e dorezave është e nevojshme për natyrën e shërbimeve që mbulon njësia në kohë, vende dhe kushte të ndryshme atmosferike.

Dhënia e kostumit civil është e nevojshme, pasi shumë punonjës të Gardës së Republikës kryejnë detyra civile.

Uniformat për oficerë e nënoficerë do të jenë njëlloj si në model, ashtu dhe në ngjyrë, ndryshimi do të jetë vetëm në grada dhe shenja dalluese.

Uniformat për ekuipazhin e motoskaftit, të helikopterit dhe të skortës së shoqërimit në model do të jetë i njëjtë me atë të Forcave Detare, Ajrore dhe Policisë së Shtetit me shenjat dalluese të Gardës së Republikës.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR SHENJAT DALLUESE TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Stema e Republikës që do të vendoset në krahun e majtë të uniformës jocivile do të jetë ajo e miratuara.

Stema e Gardës së Republikës mbetet po ajo e miratuara. Ajo prodhohet me të njëjtat përmasa me stemën e Republikës, e cila vendoset në krahun e djathtë të uniformës jocivile.

Emblema e kapelës do të jetë me ngjyrë të artë me shqiponjën e 1912-ës me përkrenaren e Skënderbeut mbi 2 kokat, të rrethuar me një kurorë me gjethe dushku.

Shiriti i kapelës së gjeneralit të Gardës së Republikës thuret me një kordon të artë. Në dy ekstremet ai montohet me kopsa vide dhe është me përmasa rreth 3 cm x 2 cm.

Shirit kapele do të jetë kordon me ngjyrë të artë është edhe për gradat e larta në Gardën e Republikës, ndryshon vetëm trashësia nga kordoni i gjeneralit të Gardës dhe është me përmasa 3 cm x 1.5 cm.

Shirit kapele kordon me ngjyrë të argjendtë dhe është për gradat e mesme në Gardën e Republikës dhe me përmasa 3 cm x 1.5 cm.

Shiriti i kapelës për tetar deri në nënoficer është me ngjyrë të argjendtë, ndryshon vetëm forma nga ajo e nivelit të mesëm. Dallimi tjetër është që nuk është kordon, por shirit i thjeshtë me përmasa 3 x 1.5 cm.

Streha e kapelës është përpiluar enkas për gjeneralin e Gardës së Republikës. Ajo paraqet një dekoracion dopio me ngjyrë të artë, i cili qëndiset direkt në strehën e kapelës. Trashësia e dekoracionit është 2.5-3 cm.

Dekoracioni i kapelës i gradave të larta në Gardën e Republikës është i njëjtë me atë të gjeneralit në formë, por ndryshon në trashësi, pasi është vetëm me një shirit. Ai vendoset direkt në strehë dhe përdoret nga major deri në kolonel. Edhe dekoracioni i kapelës së gradave të mesme është i njëjtë me atë të gradave të larta, por me ngjyrë të argjendtë. Trashësia e shiritit është 1.2 -1.5 cm.

Shenjat e jakës paraqesin një kurorë me gjethe dushku si simbol i forcës. Ajo është kompozuar për të qenë komode në jakë dhe njëkohësisht, lehtësisht e prodhueshme. Shenja e jakës që përdoret nga nënoficerët, ka vetëm një shirit kurore dhe ngjyrë të bardhë me gjerësi 1-1.2 cm dhe gjatësi 6-7 cm.

Shenja e jakës që përdoret nga gradat e mesme në Gardën e Republikës ka tri kurora në ngjyrë të argjendtë, me gjerësi 3-3.5 cm dhe gjatësi 6-7 cm.

Shenja e jakës në Gardën e Republikës për gradat e larta është në formë të njëjtë me atë të gradave të ulëta e të mesme në ngjyrë të artë. Ajo i përshtatet të gjitha dekoracioneve të gradave të larta dhe është me përmasa me gjerësi 3-3.5 cm dhe gjatësi 6-7 cm.

Dekoracioni i jakës për gjeneralin e Gardës së Republikës përfshin në ngjyrë të artë katër kurorat me gjethe dushku. Ky dekoracion përfshin të gjitha dekoracionet e gradave më të ulëta.

Stema e armës së Gardës paraqet një kala, dy shpata të kryqëzuara në pjesën e poshtme në formë gjysmërrethore ku shkruhet Garda e Republikës dhe vendoset në qendër të jakës së poshtme të xhakëtës.

Shenja e emrit të punonjësit të Gardës së Republikës paraqet një sfond të zi me kornizë të verdhë, ku në krahun e majtë qëndron një kuadrat me shenjën e flamurit dhe në pjesën tjetër vihet emri i ushtarakut me shkrim të bardhë. Shenja ka formë drejtkëndëshi me përmasa gjerësi 2.5-3 cm dhe gjatësi 7-8 cm.

Shenjat e kurseve i mbajnë punonjësit e Gardës, përkatësisht ata që kanë mbaruar këto kurse. Shenjat janë në formë shqyte me një varëse.

Kopsat paraqesin kapelën e Skënderbeut me dy shpata të kryqëzuara me simbolin më sinjifikativ të Gardës së Republikës, ku në të shkruhet në mënyrë gjysmë rrethore Garda e Republikës së Shqipërisë. Ato janë metalike, ngjyrë të artë dhe të argjendtë në varësi të nivelit të gradës. Kopsat do të jenë me diametër 2.5 cm të mëdhatë dhe 1.5 cm të voglat.

Tokëzat janë përgatitur për Gardën e Republikës. Ato janë në dy ngjyra në të argjendtë dhe bronxi. Në qendër të tyre qëndron shqiponja e flamurit. Përmasat e tokëzave do të jenë me gjatësi 5-6 cm dhe gjerësi 3-4 cm.

Shenjat e kostumit të stërvitjes do të jenë të qëndisura me përmasa pak më të mëdha nga shenjat që përdoren në kostumet e punës. Ngjyra bardhezi, pa refleks.

Shenja e identifikimit të gardistit është ngjyrë bronxi, forma ovale dhe përmban: 1. Numrin identifikues. 2. Të dhëna të koduara, 3. Grupin e gjakut etj. Përmasat do të jenë 3.5 x 2.5 cm.

Flamuri i Gardës së Republikës ka në qendër të tij përkrenaren e Skënderbeut si një nga elementet e para që paraqet shtetin shqiptar, dy shpata të kryqëzuara si simbol të forcës dhe të ceremonialit.

Shenja e oficerit të Gardës paraqet një kështjellë mbi të cilën kryqëzohen dy shpata.

Stema e komandës së Gardës është në formë shqyte me një varëse me ngjyrë kuqezi. Në mes përkrenarja e Skënderbeut me dy shpata të kryqëzuara. Stema mbahet vetëm nga komanda, në pjesën e sipërme shkruhet me germa të mëdha "GARDA".

VENDIM

Nr. 3, datë 11.2.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 22.12.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42/3 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka arsyetuar se dispozitat e sipërcituara të Kodit Penal vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, duke parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Kuptimi që i është dhënë torturës në nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal është i ndryshëm nga formulimi i përdorur në aktet ndërkombëtare. Sipas këtyre akteve, tortura konsiderohet si një veprë penale e kryer nga persona zyrtarë ose me nxitjen e tyre kryesisht ndaj personave të privuar nga liria, ose personave që përballen me organet e policisë.

- Për veprimin e torturës të kryer me dashje që ka sjellë plagosje të lehtë apo të rëndë, ligjvënësi ka parashikuar në seksionin e krimeve kundër shëndetit dy dispozita specifike (nenet 88 e 89 të Kodit Penal). Marrëdhëniet që mbrohen në këtë seksion kanë kuptim më të ngushtë se marrëdhëniet për mbrojtjen e të cilave janë miratuar aktet ndërkombëtare. Njëkohësisht, subjekti i krimit në këtë seksion nuk është person zyrtar, por subjekt i përgjithshëm.

- Ligjvënësi ka parashikuar një dispozitë të veçantë (neni 314 i Kodit Penal), përmbajtja e të cilës ka lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin që i japin termit torturë konventat ndërkombëtare.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në çështjen në ngarkim të të gjykuarit Ylli Hamzallari, i akuzuar për veprën penale të torturës parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, ka çmuar se dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë torturën vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe për rrjedhojë, në rastin konkret, nuk duhet të zbatohen. Ndodhur në këto rrethana, Kolegji Penal, në bazë të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave.

Në çështje të kësaj natyre, të cilat në jurisprudencën kushtetuese konsiderohen si çështje të kontrollit incidental, Gjykata Kushtetuese verifikon lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet ligjit që kontestohet për papajtueshmëri me Kushtetutën dhe çështjes konkrete. Për rastin në shqyrtim, kjo lidhje është e evidente, për arsye se i gjykuari është akuzuar për veprën penale të torturës, zbatimi i së cilës është vënë në dyshim nga argumentet që ka përdorur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, meqenëse argumentet e parashtruara në këtë vendim përqendrohen në kundërshtitë që, sipas kolegjit, ekzistojnë ndërmjet Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare nga njëra anë dhe dispozitave të Kodit Penal, praktikës gjyqësore dhe trajtimit doktrinar në të drejtën penale nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të shqyrtojë në thelb kërkesën lidhur me kushtetutshmërinë e dispozitave të sipërcituara.

Argumenti kryesor që përdoret në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka të bëjë me kuptimin e ndryshëm që i është dhënë termit “torturë” në nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal, në dallim nga formulimi i pranuar në nenin 25 të Kushtetutës dhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në arsyetimin e qëndrimit të tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i referohet kryesisht Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Deklaratës mbi mbrojtjen e të gjithë personave kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese dhe në veçanti Konventës kundër torturës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me Rezolutën 39/46 të 10 dhjetorit 1984.

2. Për të konkluduar mbi bazueshmërinë e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të analizojë dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë torturën, duke i ballafaquar fillimisht ato me konceptin që ka pranuar neni 25 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Në këtë dispozitë kushtetuese është parashikuar *se akush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës*. Një formulim i përafërt me këtë koncept kushtetues gjendet në disa akte ndërkombëtare, si në nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 7 të Konventës për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në nenin 86 të Kodit tonë Penal parashikohet: “Tortura si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”, ndërsa në nenin 87 thuhet: “Tortura si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

Duke iu referuar pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi për antikushtetutshmërinë e dispozitave të sipërcituara, nuk rezultojnë të jetë arsyetuar se në cilat drejtime është prekur apo kundërshtuar formulimi i sanksionuar në nenin 25 të Kushtetutës. Në kontekstin kushtetues, mosnënshtimi ndaj torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës është përfshirë si një garanci kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave vetjake të individit. Ndërkohë, nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal, të cilat janë vendosur në seksionin e III-të, ku përfshihen edhe vepra të tjera që drejtohen ndaj shëndetit të shtetasve, sigurojnë zbatimin e këtij koncepti kushtetues përmes sanksioneve në rast të konsumimit të veprës penale të torturës. Parë nga ky këndvështrim, këto dispozita penale rezultojnë të jenë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e formulimit kushtetues. Vendosja që ligjvënësi u ka bërë këtyre dy dispozitave në këtë seksion mund të jetë objekt i përpunimit nga pikëpamja e teknikave legjislative, por për jurisprudencën kushtetuese nuk përbën në vetvete çështje antikushtetutshmërie.

3. Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja në shqyrtim kërkon një interpretim më të zgjeruar në aspektin e kuptimit që i jepet termit “torturë” sipas akteve ndërkombëtare dhe në veçanti jurisprudencës së pasur që vihet re në këtë drejtim.

Neni 1 i Konventës kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese i ka dhënë një kuptim sqarues dhe orientues këtij termi. Kjo dispozitë përfshin disa elementë të rëndësishëm që duhen vlerësuar në rastet kur ndodhemi përpara konsumimit të kësaj vepre penale. Meqenëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë orientohet pikërisht nga kjo dispozitë e Konventës, çështja objekt shqyrtimi mbetet për t’u analizuar nga Gjykata Kushtetuese si në drejtim të personave që nuk duhet t’i nënshtrohen torturës, ashtu edhe të subjekteve që janë përgjegjëse për kryerjen e kësaj vepre penale.

Paragrafi i parë i nenit 1 të Konventës së sipërcituar nënkupton se vepra penale e torturës drejtohet kryesisht ndaj personave të privuar nga liria ose ndaj personave që përballen me organet shtetërore. Subjektet që kryejnë këtë vepër penale ajo i fokuson kryesisht në personat zyrtarë ose në personat që nxiten prej tyre.

Nga mënyra e formulimit të veprës penale të torturës në dispozitat e Kodit Penal, rrethi i subjekteve që mund të përgjigjen penalisht për këtë vepër merr një kuptim më të gjerë. Madje, në literaturën juridike, është pranuar se subjekti i kësaj vepre penale është subjekt i përgjithshëm ose i posaçëm, civil a ushtarak.¹ Pikërisht, një trajtim i tillë i çështjes sipas kërkuesit, prek konceptin që i japin veprës penale të torturës aktet ndërkombëtare.

Duke e analizuar çështjen në shqyrtim nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se për të konkluduar mbi pajtueshmërinë ose jo të dispozitave të Kodit Penal me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara duhet të interpretohet neni 1 i Konventës kundër torturës në kuptimin e tij të gjerë në harmoni edhe me paragrafin e dytë të tij. Sipas këtij paragrafi, kuptimi i dhënë në paragrafin e parë të nenit 1 të Konventës nuk mund të cenohet asnjë instrument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që të përmbajë dispozita të një karakteri më të gjerë.

¹ Ismet Elezi, E drejta Penale, Pjesa e posaçme faqe 71, botim i Shblu, Tiranë 2002.

E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut sanksionon si rregull vetëm një minimum bazë të lirive dhe të drejtave, ndërkohë që shtetet palë në konventat ndërkombëtare mund të ngrihen mbi këto minimume dhe të implementojnë ligje kombëtare që përmbajnë ose mund të përmbajnë dispozita të një karakteri më të gjerë. Pra, kjo dispozitë e Konventës nuk vendos kufizime për shtetet palë, përkundrazi, e lë në diskrecionin e tyre që të vendosin në legjislacionin e brendshëm rregulla të një spektri më të gjerë.

Tortura dhe çdo trajtim çnjerëzor e degradues janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare penale. Ndalimi i torturës dhe trajtimeve poshtëruese e degraduese gjen pasqyrim të plotë në shumicën e traktateve ndërkombëtare. Detyrimi për të mos iu nënshtuar torturës apo keqtrajtimit është një rregull i së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe se ndalimi i torturës përbën një normë të pakundërshtueshme.²

Ndalimi i torturës në kuadrin e sanksionimit të të drejtave të tjera të njeriut në aktet ndërkombëtare përbëjnë një garanci për qytetarët jo vetëm ndaj abuzimeve shtetërore, por edhe ndaj abuzimeve të individëve. Aktet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e zhvilluar në këtë drejtim e kanë lidhur të drejtën për të mos ju nënshtuar torturës dhe keqtrajtimit, me detyrimin e shtetit për të siguruar mbrojtje nëpërmjet masave legjislative ose masave të tjera kundër torturës apo keqtrajtimit nga individët. Qëllimi i dispozitave që ndalojnë përdorimin e torturës është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit. Ndaj është detyrë e çdo shteti palë në këto marrëveshje ndërkombëtare të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara nga aktet ndërkombëtare, “...pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar, jashtë kapacitetit të tillë zyrtar ose në kapacitet privat”.³

4. Krahas këtij trajtimi doktrinar dhe evolutiv që vihet re në jurisprudencën ndërkombëtare argumente tepër të rëndësishme për të konkluduar për zgjidhjen e çështjes konkrete gjenden edhe në praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen *A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ajo konkludon se “detyrimi i shteteve anëtare nga neni 1 i Konventës për t’i siguruar kujt do që është nën juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e shprehura në Konventë e kombinuar së bashku me nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë”.⁴ Pikërisht bazuar mbi një konkluzion të tillë, dështimi që mund të vihet re në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁵

Nisur nga kjo analizë me karakter interpretues, bazuar edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese konkludon se për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjeri ka të drejtë për të mos iu nënshtuar torturës apo keqtrajtimeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individit. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publikë, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t’i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.

² Shih më gjerë Komentin e përgjithshëm 24 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të P.D.C.P.

³ Shih për me gjerë, Komentin e Përgjithshëm 20, para.,2 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të P.D.C.P.

⁴ A. v. Mbretërisë së Bashkuar, para 21.

⁵ Kjo gjykatë në një çështje analoge ka nënvizuar se “përgjegjësia e shtetit... mund të jetë kur kuadri ligjor dështon për të siguruar një mbrojtje adekuate ose kur autoritetet dështojnë të marrin masa të arsyeshme për të shmangur rrezikun e keqtrajtimit kur e dinin ose duhet ta dinin këtë rrezik.”. Mahmut Kaya. v. Turqisë, para 115.

Nga sa argumentuam më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal është e pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.5483, me kërkesë të shtetases Sybe Hida vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Leonidha Hida.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.5580, me kërkesë të shtetases Nexhmije Mema vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllumb Mema.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1. KUSHTETUTA	600
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3. KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4. KODI PENAL	400
5. KODI I PUNËS	500
6. KODI I FAMILJES	450
7. KODI CIVIL	1000
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9. KODI ZGJEDHOR	355
10. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 19.2.2004

Tirazhi: 4500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 100 lekë